



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:006893

Datë: 15.07.2020

Numri i dokumentit: 01025390

C.nr.30/2020

**GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË -Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil- më** gjyqtarin Prenk Palushi,dhe asistentën administrative Violeta Lecaj-Lulaj duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësës: M. H. F. e lindur M. nga Klina Rr. "A. K." nr.... ,kundër të paditurit : E. H. M. nga fsh S. K.Klinë me vendqëndrim në Gjermani ,të cilin e përfaqëson A. M. nga fsh. S. K.Klinë ,baz juridike: vërtetim i te drejtës se pronësisë , vlera e kontestit 1000 euro , pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me dt.24.06.2020, në të cilët prezantuan paditësja, si dhe i autorizuari i të paditurit, me dt.15.07.2020 bijë këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**në bazë të pohimit**

**I. APROVOHET SI E BAZUAR-** Kërkesëpadia e paditësës: M. H. F. e lindur M. nga Klina Rr. "A. K." nr....

**II. VËRTETOHET- se:** M. H. F. e lindur M.nga Klina Rr. "A. K." nr...., është pronare e paluajtëshmërisë të shtrirë në parcelat kadastrale : nr.P-..... ZK.S...vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ...m2, nr. P-..... ZK. S...vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ...m2, nr. P-..... ZK. S...vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ....m2, nr. P-..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... -oborr në sipërfaqe prej ...m2, nr. P-..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... -oborr në sipërfaqe prej ...m2 si dhe në 1/3 ne pjese ideale të parcelës kadastrale nr. P-....., që të gjitha në certifikatën e pronës te drejtorisë përkatëse janë te evidentuara ne emër të E. H. M. nga fsh S... K.Klinë

**III. OBLIGOHET** – i padituri që të drejtën e pronësisë në paluajtëshmerin e theksuar si më lartë të ja njoh dhe pranoj palës paditëse, në atë mënyrë që i njëjti të përmbahet lidhur më regjistrimin e të drejtës se pronësisë së paditësit në regjistrin e të drejtave për pronë të paluajtshme të Drejtorisë për Gjeodezi Kadastër e Pronësi K.Klinë, dhe këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

**IV.** Shpenzimet procedurale i bart pala paditëse

**A r s y e t i m**

Paditësja: M. H. F. e lindur M.nga Klina Rr. "A. K." nr....,në shqyrtimin kryesor si dhe në fjalën përfundimtare deklaron së me palën e paditur ,gjithashtu edhe me të autorizuarin e tij qëndrojnë në raporte familjare ,motër e vëllezër ,andaj edhe parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesëpadisë i takojnë palës paditëse nga baza e trashëgimisë ,me që deri me tani për shkaqe objektive dhe subjektive në cilësinë e pasardhësit e trashëgimlënësit nuk e ka bërë shqyrtimin e trashëgimisë në procedurë jokontestimore .

Andaj i propozon gjykatës që padinë dhe kërkesën e saj ta aprovoj si të bazuar ,me që plotësohen kushtet ligjore për një gjë të tille ,pasi që as pala e paditur nuk e konteston të njëjtën .

I autorizuari i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare deklaronë se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesën e saj ,as gjëndjen faktike ,përkatësisht faktet në të cilat mbështetet e njëjta ,me arsyetimin se me palën paditëse qëndrojnë në raporte familjarë motër –vëllezër, andaj edhe parcelat kadastrale të pretenduar në padi të cilat gjënden në emër të të paditurit i takojnë paditëses , të gjitha në tërësi ashtu siç është pretenduar në kërkesëpadi ,ndërkaq parcela kadastrale nr..... i takon të njëjtës ne pjesë ideale me 1/3, andaj e pohojn në tërësi kërkesëpadinë ,ashtu që paditësja të fitoj të drejtën e pronësisë në parcelat kadastrale nr..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ...m2, nr..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ...m2, nr..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ....m2, nr..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m...-oborr në sipërfaqe prej ...m2, nr..... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... -oborr ne sipërfaqe prej ...m2.

Me pohimin e fakteve nuk është e nevojshme gjykata ti provoj të njëjtat ndërkaq me pranimin e kërkesëpadisë pushon nevoja e zbatimit te se drejtës materiale në gjëndjen e konstatuar faktike ,mirëpo gjykata zbaton procedurën e provave për te vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjëndjen faktike ,gjatë të cilës lexon prova materiale si në vijim : Nga çertifikat e pronës e lëshuar nga D.GJ.K.P.Klinë nr..... u vërtetua se paluajtëshmeria lëndore e shtrirë në parcelat kadastrale nr. .... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ...m2, nr. .... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ...m2, nr. .... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... në sipërfaqe prej ....m2, nr. .... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... -oborr në sipërfaqe prej ...m2, nr. .... ZK. S..., vendi i quajtur a... e m... -oborr në sipërfaqe prej ...m2, si dhe në 1/3 ne pjese ideale të parcelës kadastrale nr. P-.....,që të gjitha në çertifikatën e pronës të drejtorisë përkatëse janë te evidentuara ne emër të E. H. M. nga fsh S. K.Klinë me nr personal .....

Konform dispozitave ligjore të nenit 20 të ligjit mbi marrëdhëniet juridike pronësore e drejta e pronësisë fitohet sipas vet ligjit ,në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi .E drejta e pronësisë fitohet edhe me vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj .Sipas vet ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimit të sendit të ri me bashkim, më përzierje ,me ndërtim në token e huaj ,me ndarjen e fryteve ,me parashkrim fitues, fitim të pronësisë nga jo pronari ,me okupim dhe në rastet e tjera të caktuara me ligj.

Konform dispozitave ligjore të nenit 3.3 gjykata vijë deri të përfundimi se palët ndërgjyqëse në këtë qeshtje juridiko civile kanë të drejte të disponojnë lirisht me kërkesat e tyre, si dhe të ndërmarrin veprime disponibile në këtë çështje juridiko civile më që të njëjtat nuk janë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore,dhe rregullat e moralit publik, andaj në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura si dhe konform nenit 148 të LPK-së gjykata bije aktgjykim në bazë të pohimit ,më që pala e paditur përmes të autorizuarit të saj e pohon në tërësi kërkesëpadinë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjor të lartëtheksuara në çështjen konkrete juridiko-civile ,gjykata vije deri të përfundimi se pala paditëse ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të veprimit juridik– kontratës me shkrim , në bazë të se cilës te dy palët kontraktuese kanë shprehur vullnetin e tyre te plotë për elementet themelore të kontratës

Në çështjen konkrete juridiko civile paditësja të drejtën e pronësisë në paluajtëshmerinë lëndore e ka fituar nga baza e trashëgimisë pas ndarjes faktike të bashkësisë familjare ,pas të cilës kohë paluajtëshmerinë lëndorë paditësja e ka pasur në posedim dhe shfrytëzim të lirë faktik.

Gjykata në bazë të provave materiale të nxjerra dhe administruara ne shqyrtim kryesor vertetoi legjitimitetin real pasiv e palës së paditur si dhe legjitimiteti –real aktiv të palës paditëse në këtë qeshtje juridiko civile.

Konform dispozitave ligjore të nenit 452 të LPK-së u vendos për shpenzime procedurale sikurse në pikën 4 te dispozitivit të ketij aktgjykimit.

Andaj nga arsyet e theksuara më lartë konform dispozitave ligjore të nenit 142 dhe 148 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË KLINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil**  
**C.nr.30/2020, me dt. 15.07.2020**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ngritët ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

**G j y q t a r i**  
**Prenk Palushi**